



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1044/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Floriana Halili kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1044/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Floriana Halili kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet 2113B/01R, 2113B/02R, 2113B/03D, 2105B/01R, 2105B/02R, 2105B/03R, 2105B/04D, 2101X/01R, 2112B/01R, 2112B/02D, 2114B/02R, 2129B/01D, 2106B/01R, 2106B/02R, 2106B/03R, 2106B/04D, 2107B/01R, 2107B/02R, 2107B/03R, 2107B/04D, 0202X/016R dhe në qendrat e votimit 0225C, 0221C, 0214C, 0210C.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1044/2021 të paraqitur nga Floriana Halili kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2113B/01R, 2113B/02R, 2113B/03D, 2105B/01R, 2105B/02R, 2105B/03R, 2105B/04D, 2101X/01R, 2112B/01R, 2112B/02D, 2114B/02R, 2129B/01D, 2106B/01R,

2106B/02R, 2106B/03R, 2106B/04D, 2107B/01R, 2107B/02R, 2107B/03R, 2107B/04D, 0202X/016R dhe në qendrat e votimit 0225C, 0221C, 0214C, 0210C.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i paraqitur nga Floriana Halili kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet e lartcekura, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur i njëjti i ka propozuar tre dëshmitare por te njetit nuk kanë bashkangjitur deklarate në shkresat e lëndës. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret, deklarata apo ndonjë formular, por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1044/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesues i Panelit
Zyhdi Hazir**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.